



[Handwritten mark]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1607 Prot

Elbasan më 14 /04/2020

VENDIM

Nr. 37 datë 14 /04/2020.

Mbi përdorimin e fondit të emergjencës civile për dhënien e ndihmës ekonomike të dyfishuar nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin SHKURT 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”, VKM nr 254, 27.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milione leke, ndihmës ekonomike dhe pagesës së të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqesisë natyrore, tëshpallur si pasojë e COVID-19”, si dhe Urdhërit Nr 92/4 datë 27.03.2020 “Për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë si pasojë e epidemisë së shkaktuar nga infeksioni covid-19”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 81 familje me fond 268.420 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Për financimin sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përdoret fondi i emergjencës civile për shumën 269 mijë lekë.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Adresa Bashkia Elbasan, Rr. “Q.Stafa”, Tel. +355 54 400152, e-mail bashkia@elbasan.gov.al web www.elbasan.gov.al



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1685 Prot.

Datë 14 .04. 2020

VENDIM

NR. 38 DATË 14 .04. 2020

MBI

“Transferim fonde nga granti, për bonusin e strehimit”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ . 04. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Transferim fonde nga granti, për bonusin e strehimit”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, vKB nr.201, datë 24.12.2019 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”, vKB nr.171, datë 04.12.2019 “Mbi miratimin e listës emerore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2020, në qytetin e Elbasanit”, si dhe shkresën nr.5462, datë 12.03.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekomomisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e fondit 4,173,548 lekë, financim i Bashkisë Elbasan për plotësimin e shumës së subvencionimit të qirasë, bazuar në listën e familjeve përfituese për vitin 2020 (janar – dhjetor), miratuar me vKB, nr.171, datë 04.12.2019. (Bashkëfinancim i Ministrisë së Financave dhe Bashkisë Elbasan).
2. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2020, për financimin e pikës 1 të këtij vendimi, si më poshtë :

Paksohet :

- 4,174 mijë lekë, programi 06330, kap 01, artikulli 231, institucioni ASHP, objekti :
“Ndërtim puse shpimi+investime për marrje ujë të pijshëm, në fshatrat Griqan i Sipërm,
Gur i Zi, Mollagjesh dhe Letan”,

Shtohet :

- 4,174 mijë lekë, programi 10661, kapitulli 01, artikulli 606, institucioni Bashkia.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi



KRYETARI
Hektor Ciftja



2

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1688 / Prot.

Datë 14 .04. 2020

V E N D I M

Nr. 38 Datë 14 . 04.2020

*“Mbi Miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime ne programin social
“Rikonstruksion banesash”, në bashkëfinancim me MFE ”*

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __.04. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan “Mbi Miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime ne programin social “Rikonstruksion banesash”, në bashkëfinancim me MFE” bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social VKM nr. 454, datë 3.7.2019, VKM nr. 458, datë 3.7.2019, Bashkia Elbasan po aplikon pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për projektet e investimit mbi “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2020.

V E N D O S I:

1. Miraton në parim financimin në masën 20% të programit social “Rikonstruksion banesash”, në bashkëfinancim me MFE për vitin 2020.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës dhe Sektori Projekteve.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja





5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1086/11 Prot.

Datë 14 .04. 2020

VENDIM

NR. 40 DATË 14 . 04. 2020

MBI

“Përdorim i fondit të emergjencave civile, për shkak të gjendjes së pandemisë nga “Kovid-19”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ . 04. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Përdorim i fondit të emergjencave civile, për shkak të gjendjes së pandemisë nga “Kovid-19”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.68/2017, date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore”, VKM nr.236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtesave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Vendimit Nr.2 datë 24.03.2020 të KQOA “Për përcaktimin e masës së produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, minimale dhe llojin e procedurave të asistencë ndaj shtesave në nevojë “ të Komisionit Qëndrorë të Ofritit të Asistencës si dhe Vendimit Nr. 6 datë 11.04.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.2 datë 24.03.2020 të KQOA për përcaktimin e masës së produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, minimale dhe llojin e procedurave të asistencë ndaj shtesave në nevojë “ të Komisionit Qëndrorë të Ofritit të Asistencës”, VKB nr.201, datë 24.12.2019 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”,

VENDOSI :

1. Përdorim i fondit të emergjencave civile për “Blerje produkte ushqimore dhe joushqimore , për familjet në nevojë, si pasojë e situatës së krijuar nga Kovid-19”, për shumën 13,316,028 lekë, nga të ardhurat, duke ndryshuar zërat e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2020, si më poshtë :

6

Paksohet :

- 13,317 mijë lekë, emergjencat civile (programi 03280), artikulli 609, njësia shpenz. Bashkia

Shtohet :

- 13,317 mijë lekë, emergjencat civile (programi 03280), artikulli 602, njësia shpenz. Bashkia

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria e Emergjencave Civile dhe administrata e Bashkisw Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Ciftja

